



C.nr.51/17

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, Gjyqtari Alban Beqiri, me sekretaren juridike Lendita Pajziti në çështjen juridike të paditëses [REDACTED] të cilën e përfaqëson me autorizim [REDACTED] kundër të paditurit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Shtime, të cilin e përfaqëson me autorizim av. [REDACTED] në çështjen juridike borxh në shumën prej 5.340.27€, në prezencën e të autorizuarës të paditëses, dhe në prezencën e të autorizuarit të paditurit, në shqyrtimin e mbajtur me dt.15.06.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. **REFUZOHET** në tërësi kërkesë padia e paditëses, [REDACTED]

[REDACTED] e paraqitur kundër të paditurit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Shtime, me të cilën ka kërkuar që të **DETYROHET** i padituri, që paditëses t'i paguajë borxhin në shumë prej 5.340.27€, (pesë mijë e treqind e katër dhjetë euro e njëzet e shtatë cent), në emër të shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën nga viti 2002 e deri më dt.18.03.2009, me kamatë ligjore si përmjetet e deponuara në bankë mbi një vit pa destinim të caktuar, nga data 25.05.2009, deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 100,oo€, të gjitha në afat prej 15 dite, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të përbëmbarimit, si e pa bazuar.

II. **DETYROHET** paditësja që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 100€, brenda afatit prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përbëmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Gjykata pas pranimit të aktvendimit të gjykatës së Apelit Ac.nr.4450/14 të dt.13.01.2017 në lidhje me shkaqet e prishjes së aktgjykimit të kësaj gjykate C.nr.217/10 të dt.01.09.2014, pas analizimit të njëjtit ka caktuar seancën gjyqësore.

Paditësja përmes të autorizuarës së saj ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesë padisë thëniet e cekura në seancat e kaluara duke shtuar se paditësja me të paditurën

kanë marrëdhënie kontraktuale për furnizimin me energji elektrike respektivisht paditësi është shfrytëzues i energjisë elektrike të cilën edhe pse e ka shpenzuar nuk e ka paguar andaj, i njëjtë ka për obligim që paditëses tia paguaj borxhin në emër të energjisë së shpenzuar në lartësinë si në kërkesë padi.

Sa i përket pretendimit të paditurit në përgjigje në padi se kërkesë padia është e parashkruar ka ritheksuar se i padituri duke marr parasysh transaksionin ka bërë pagesa kohë pas kohe të energjisë elektrike me të cilin veprim edhe është ndërprerë parashkrimi duke kërkuar nga ana e gjykatës që kërkesë padinë ta aprovoj në tërësi si të bazuar.

I padituri përmes të autorizuarit të tij ka deklaruar, se mbetet edhe më tutje pranë përgjigjes në padi thëniet e cekura në seancat e kaluara duke shtuar se paditësa edhe më tutje nuk e ka provuar bazueshmërinë e kërkesë padisë njëherit ka shtuar se kërkesë padia e paditëses është e parashkruar pasi që me dispozitat ligjore të nenit 378 LMD-së, i vjetëri, si dhe me nenin 360 të LMD-së i ri këto lojë kërkesa parashkruhet brenda një viti.

Andaj, mbi këtë bazë ka kërkuar që kërkesë padia e paditëses të refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

Gjkata me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje, bëri administrimin e provave U lexua aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.217/10 i dt.01.09.2014, ankesa e të paditurit e dt.04.11.2014, aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë Ac.nr.4450/2014, i dt.13.01.2017, autorizimi i të paditurit dhënë av. [REDACTED], autorizimi i paditëses dhënë përfaqësueses [REDACTED].

Gjkata pas vlerësimit të provave të administruara një nga një dhe të gjitha sbashku në kuptim të nen. 8 të LPK-së, gjeti se kërkesë padia e paditëses është e pa bazuar.

Gjkata erdhi në përfundim se në mes palëve ndërgjygjëse nuk është kontestuese ekzistimi i marrëdhëniejës juridike në mes paditëses dhe të paditurit për furnizim me energji elektrike, por kontestuese ishte se kërkesë padia a është e parashkruar apo jo.

Meqë nga provat e administruara u vërtetua se i padituri ka qenë shfrytëzues i energjisë elektrike në kuptim të nenit 15 të LMD-së dhe nga ky raport janë krijuar të drejtat dhe detyrimet

në kuptim të nen. 130 të LMD-së i cili fakt vërtetohet nga provat e administruara-faturat, transaksi me të cilën vërtetohet shpenzimin e energjisë elektrike për njehsorin në emër të paditurit [REDACTED]

Nga transaksi i konsumatorit i dt.09.10.2014, shihet qartë se edhe pse i padituri ka qenë shpenzuar i energjisë elektrike i njëjtë nga viti 2002, deri me dt.06.06.2011, nuk ka paguar asnjëherë energjinë elektrike, duke marr parasysh se fillimisht propozimi tani padia e paraqitur në gjykatë me dt.25.05.2009, bazohet në faturën e dt.18.03.2009, në njëren anë dhe se paditësi nuk e ka bërë precizimin të kërkesë padisë edhe pas pranimit të përgjigjes në padi nga ana e të paditurit dhe as në seancën e dt.15.06.2017, gjykata konsideroj se kërkesë padia është e parashkruar dhe mbi këtë bazë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pretendimet e paditëses se me veprimet e të paditurit duke bërë pagesa në emër të energjisë elektrike është bërë ndërprerja e parashkrimit gjykata konsideroj se këto pretendime janë të pa bazuara për faktin se nga transaksi i konsumatorit me shifër DFE.nr. [REDACTED] i dt.09.10.2014, shihet se i padituri tek nga data 06.06.2011, ka filluar me pagesa të energjisë elektrike, kurse padia është e paraqitur në gjykatë me dt.25.05.2009, e cila padi është e bazuar në faturën e dt.18.03.2009, në të cilën kohë paditësi nuk ka bërë asnjë pagesë të energjisë elektrike dhe kërkesa është e parashkruar, duke marr parasysh këtë rrethanë edhe pse paditësja në seancën e dt.15.06.2017, nuk e ka bërë precizimin e kërkesë padisë as për nga periudha kohore dhe as për nga lartësia e saj gjykata konsideroj se pretendimet e të paditurit se kërkesë padia e paditëses është e parashkruar e vlerësoj dhe ka vendosur duke u bazuar në nenin 360 të LMD-së, për faktin se për periudhën të cilën kërkohet borxhi i padituri nuk provohet se ka bërë ndonjëherë pagesë të energjisë elektrike me të cilin veprim do të ndërpritej parashkrimi ashtu siç pretendon paditësja, kurse pagesa e bërë me dt.06.06.2011, nuk nënkupton se është ndërprerë parashkrimi pasi që padia bazohet në faturën e dt.18.03.2009, në të cilën periudhë ashtu siç u konstatua i padituri nuk e ka ndërmarr asnjë veprim- pagesë në emër të energjisë elektrike me të cilin do të ndërpritej parashkrimi.

Gjkata vendimin mbi shpenzimet e mbështeti në nenin 452.1 të LPK-së dhe e obligoi paditësen që të paditurit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 100 euro dhe atë taksën gjyqësore për padi shumën prej 50€ dhe për përpilim të aktgjykimit shumën

prej 50€, meqenëse nga ana e të autorizuarit të padituri nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës gjykata nuk ka vendosur në lidhej me to.

Nga sa u tha më lart u vendosë si në dispozitiiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
C.nr.51/17 më dt.15.06.2017



Gjyqtari,
Alban Beqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite, nga dita e pranimit, drejtar Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

